



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 124

Tiranë – E martë, 30 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 15, datë 19.5.2017	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017 – 2018..... 6389
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 11.5.2017	Mbi miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe furnizuesit të shërbimit universal OSHEE sh.a. për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017..... 6397
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 63, datë 11.5.2017	Për miratimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike..... 6413
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 11.5.2017	Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017..... 6417
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 65, datë 11.5.2017	Për licencimin e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 6417
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 11.5.2017	Mbi miratimin e kërkesës për lënie peng të aseteve të shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a..... 6418
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 11.5.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 6419

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 11.5.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..	6420
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 11.5.2017	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike.....	6420
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 11.5.2017	Për licencimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6421
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 11.5.2017	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6422
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 11.5.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 16.5.2017	Mbi licencimin e shoqërisë CGC sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.....	6423
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 2276/5, datë 25.5.2017	Për marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të përhershëm të kalimit, për pasuritë e paluajtshme që preken nga ndërtimi i korridorit të ndërtimit (pjesa e dytë), sistemit të gazsjellësit (pjesa e dytë) në zonat Korçë, Devoll, Berat, Skrapar, pjesë e projektit TAP.....	6424

**UDHËZIM****Nr. 15, datë 19.5.2017****PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2017 – 2018**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 19.4.2017, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”,

UDHËZOJ:**KREU I****PORTALET E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT**

1. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z dhe përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2017-2018, bëhet në Portalin e Maturës Shtetërore *online*: www.matura.qsha.gov.al.

2. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar *online* formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në portalin “Maturantë”: www.rezultateam.al.

3. Regjistrimi i fituesve të shpallur nga IAL-të bëhet nga sekretariatë mësimore dhe pasqyrohet në portalin U-Albania: www.ulbania.arsimi.gov.al.

4. Për të gjithë maturantët e vitit shkollor 2016-2017, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në Portalin Online të Maturantit të

dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

Deri më 31 maj 2017 hidhen rezultatet e arsimit të mesëm, me përjashtim të atyre të vitit të fundit. Rezultatet e vitit të fundit hidhen gjatë muajit qershor, pas përfundimit të vitit shkollor.

5. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm përpara vitit shkollor 2016-2017 dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2017 në Portalin Online të Maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

6. Për të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen deri më 30 qershor 2017 në Portalin Online të Maturantit të gjitha të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

KREU II**RAUNDI I PARË****A. Procedurat e aplikimit**

1. Të gjithë maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të, publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit *online* në Portalin Matura Shtetërore Online.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;

b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilat aplikojnë;

d) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë,



në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare elektronike të QSHA-së: www.qsha.gov.al.

4. Deri më 18 korrik 2017, QSHA-ja do t'iu përcjellë shkollave të mesme përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM-së.

5. Maturantët/kandidatët dorëzojnë në shkollën ku kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z mandatin e pagesës së kryer. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në portalin e Maturës Shtetërore Online notën mesatare të llogaritur nga QSHA-ja, në zbatim të VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017.

6. Maturantët/kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM-në nr. 346, datë 19.4.2017.

7. Në periudhën 20 - 29 korrik 2017, të gjithë maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit dhe hedhjes në sistem të notës mesatare, do të aplikojnë në Portalin e Maturës Shtetërore Online, nëpërmjet formularit të aplikimit. Aplikimi kryhet për çdo DAR/ZA, sipas kalendarit të publikuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së).

9. Maturantët/kandidatët aksesohen në portal me kredencialet e tyre: ID e kandidatit; emri, atësia, mbiemri; karta e identitetit; *email*-i i kandidatit etj. Kandidatët zgjedhin deri në 10 (dhjetë) programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/jopublike, për vitin akademik 2017-2018.

10. DAR/ZA-të duhet të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

11. Portali i Maturës Shtetërore Online nuk do të pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM për programet e ciklit të

parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur

1. Brenda datës 8 gusht 2017, QSHA-ja iu përcjell IAL-ve që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.

2. Më datë 9 gusht 2017, të gjitha IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11 deri 22 gusht 2017 do të zhvillohen konkurset/testimet.

3. Brenda datës 23 gusht 2017, QSHA-ja iu përcjell të gjitha IAL-ve, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;

b) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

c) rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;

d) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;

f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017;

g) indekset e profileve të shkollave të mesme.

4. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së përllogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kriterëve të pranimi të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishon në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

5. Brenda datës 28 gusht 2017, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit



ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 28 gusht 2017, IAL-të i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së. Gjithashtu, brenda datës 28 gusht 2017, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 29 gusht deri 11 shtator 2017, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritetë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha 29 gusht deri 11 shtator është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MAS dhe QSHA do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe www.qsha.gov.al.

4. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritetë mësimore, me dokumentacion dhe *online*, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

5. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 11 shtator 2017.

6. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria pasqyron regjistrimin e tij edhe *online* në Portalin U-Albania. Aplikantët

dorëzojnë, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në MAS;

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

7. Sekretaritetë mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit pasqyrohet regjistrimi i tij edhe *online* në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

8. Brenda datës 13 shtator 2017, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në *hard copy*.

9. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

Ç. Procesi i çregjistrimit

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm më datë 12 shtator 2017. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për atë vit akademik.

2. Sekretaritetë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QSHA-së, brenda datës 13 shtator, listën e aplikantëve të çregjistruar, si dhe



pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto lista në format elektronik.

D. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datat 29-30 gusht 2017. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA, brenda datës 1 shtator 2017, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata mund të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen sipas dëshirës në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm më datë 12 shtator 2017.

KREU III RAUNDI I DYTË

A. Procedurat e aplikimit

1. Në periudhën 15 shtator - 22 shtator 2017 do të kryhet procesi i aplikimit *online* për raundin e dytë në Portalin e Maturës Shtetërore Online. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 (dhjetë) preferenca, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e Maturës Shtetërore, por që:

- a) nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë;
- b) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues;
- c) kanë kryer procesin e aplikimit *online* në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen;
- d) janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimet për çdo DAR/ZA do të kryhen sipas kalendarit të publikuar në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Deri më datë 10 shtator 2017, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë

maturantët/kandidatët që kanë rezultuar kalues në provimet e sesionit të dytë (sesioni i vjeshtës), menjëherë pas publikimit të rezultateve të provimeve të këtij sesioni, hidhen në Portalin Online të Maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm.

4. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti (sipas procedurave të përshkruara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së).

5. DAR/ZA-të të marrin masa për krijimin e kushteve (mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'i ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

6. Maturantët/kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit në Portalin e Maturës Shtetërore, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lekë. Mandati i pagesës së kryer dorëzohet në shkollën përkatëse, ku maturantët/kandidatët kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit prej 2000 lekësh.

7. Deri më datë 14 shtator 2017, QSHA-ja do t'i përcjellë shkollave të mesme përlllogaritjen e notës mesatare sipas VKM-së.

8. Maturantët/kandidatët dorëzojnë në shkollën ku kanë kryer plotësimin e formularit A1/A1Z mandatin e pagesës së kryer. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave hedhin në portalin e Maturës Shtetërore Online notën mesatare të llogaritur nga QSHA-ja, në zbatim të VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017.

B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlllogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur

1. Brenda datës 27 shtator 2017, QSHA-ja iu përcjell IAL-ve, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

- a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi;
- b) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme;



c) rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore;
d) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme;

e) mesataren e provimeve të Maturës Shtetërore;
f) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së nr. 346, datë 19.4.2017;

g) indekset e profileve të shkollave të mesme.

2. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

3. Brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të i përcjellin zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së. Gjithashtu, brenda datës 30 shtator 2017, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

C. Procesi i regjistrimit

1. Në datat 1 tetor deri 14 tetor 2017, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretaritë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha 1 tetor deri 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe, MAS dhe QSHA do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe www.qsha.gov.al.

3. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mësimore, me dokumentacion dhe *online*, vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e rankuara të raundit të dytë.

4. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave.

5. Sekretaritë mësimore do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë aplikantët fitues që dëshirojnë të regjistrohen vetëm në një program studimi. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin *online* në Portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja;

b) fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në MAS;

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij Udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

6. Sekretaritë mësimore të fakulteteve të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit pasqyrohet regjistrimi i tij edhe *online* në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

7. Brenda datës 20 tetor 2017, IAL-të përcjellin në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe *hard copy*.



8. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit për atë vit akademik.

Ç. Procesi i ankimimit

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datat 1 - 2 tetor 2017. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në QSHA, brenda datës 4 tetor 2017, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata mund të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen sipas dëshirës në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm më datë 16 tetor 2017.

KREU IV DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI

1. Portali Matura Shtetërore Online është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a) procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të Maturës Shtetërore 2017, që synojnë të bëhen pjesë e garës për t'u shpallur fitues dhe regjistruar në njërin prej programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik 2017-2018;

b) digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve;

c) procesin e përzgjedhjes nga maturantët/kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të (publike dhe jopublike) për vitin akademik 2017-2018.

2. Portali Maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë proceset e mëposhtme:

a) regjistrimin dhe administrimin e rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në Portalin Matura Shtetërore Online;

b) përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.

3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të mundësojë me transparencë të plotë:

a) informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për vitin akademik 2017-2018 dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar:

i) kriteret e pranimi;

ii) kuotat e pranimi;

iii) programet mësimore, kurrikulat etj.

b) dhënien *online* të informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE

1. Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.

2. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve shtetas të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018 do të bëhet sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.

3. Aplikimi për program të dytë studimi dhe për transferimin e studimeve do të bëhet në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimit të posaçëm të MAS.



4. Aplikimi për programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, si dhe programet specializuese afatgjata do të bëhen në institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të udhëzimeve të posaçme të MAS.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 15 nëntor 2017, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar, si dhe deklaratën sipas shtojcës nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi. QSHA-ja u dërgon IAL-ve, brenda datës 31.12.2017, numrat individualë të regjistrimit (matrikullimit) të studentëve të regjistruar.

2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të

regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtin vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore”. Ky raport të dërgohet në MAS brenda datës 15 dhjetor 2017.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

Shtojca nr. 1

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E PARË PLANI KALENDAR I APLIKIMIT ONLINE ME FORMULARIN E APLIKIMIT NË IAL

Datë	DAR/ZA							
20.7.17	Tirana qytet	Tirana qark						
21.7.17	Tirana qytet	Tirana qark						
22.7.17	Tirana qytet	Tirana qark	Kamzë	Kavajë	Durrës	Krujë		
23.4.17	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		
24.7.17	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll
25.7.17	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
26.7.17	Shkodër	M. Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbin	Mirditë		
27.7.17	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastrë	Tepelenë	Përmet		
28.7.17	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë
29.7.17	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë



Shtojca nr. 2

KALENDARI I APLIKIMEVE PËR RAUNDIN E DYTË

Datë	DAR/ZA							
15.9.17	Tirana qytet	Tirana qark						
16.9.17	Tirana qytet	Tirana qark	Kamzë	Kavajë	Durrës	Krujë		
17.9.17	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë		
18.9.17	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar		
19.9.17	Shkodër	M. Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbini	Mirditë		
20.9.17	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastër	Tepelenë	Përmet		
21.9.17	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll
22.9.17	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë	Rezervë

Shtojca nr. 3

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____ me kartë identiteti/pasaportë nr. _____
emri atësia mbiemri

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: _____

Data: _____._____._____

**VENDIM****Nr. 62, datë 11.5.2017**

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
SHITBLERJE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI/KESH SH.A.
DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL OSHEE SH.A. PËR
PERIUDHËN 1.1.2017 – 31.12.2017**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5 dhe 14 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017,

Konstatoi:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Në nenin 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, parashikohet se: Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin

e energjisë elektrike”, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

- ERE, me vendimin nr. 22, datë 15.2.2017, ka nisur procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Kontratës tip, për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal, për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017”.

- ERE, me shkresën nr. 177 Prot., datë 23.2.2017, ka përcjellë draft – “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI, Autoriteti i Konkurrencës.

- ERE, në datën 3.3.2017, zhvilloi një seancë dëgjimore me palët KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI për të diskutuar në lidhje me përmbajtjen e draftkontratës tip, “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal, për periudhën kohore 1.1.2017 – 31.12.2017”. Në këtë seancë nuk u arrit të dakortësohej sasia e energjisë elektrike që palët do të shitblenin ndërmjet tyre.

- Në vendimin nr. 194, datë 30.12.2016, të Bordit të ERE, është përcaktuar se: 1- OST sh.a. të lidh kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a., për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe balancimit për vitin 2017, sipas marrëveshjes së miratuar me vendimin nr. 79, datë 7.6.2016 “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a. dhe në përputhje me çmimin e përcaktuar sipas vendimit të bordit të



ERE-s, nr. 141, datë 26.12.20142 - deri në miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për të cilën kanë filluar procedurat me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a. të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016 të bordit të ERE.

- Me vendimin nr. 52, datë 6.4.2017, bordi i ERE-s në pikën 3 të vendimit rikonfirmoi se: Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a. të vijojë të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016 të Bordit të ERE deri në afatin e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

- Regjimi racional i shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese, si dhe niveli historik mesatar vjetor për një periudhë 25-vjeçare (1991-2016), të prodhimit të KESH sh.a. prej kaskadës së lumit Drin është rreth 4.200.000 GWh.

- Energjia mesatare vjetore për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit llogaritet në 89 GWh/vit.

- Energjia mesatare për mbulimin e humbjeve dhe nevojave vetjake të sistemit të transmetimit për vitin 2017, llogaritet 161 GWh/vit.

- Sasia vjetore e energjisë që KESH sh.a. duhet të programojë për FSHU rezulton rreth 3 950 GWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017 (kontrata bashkëlidhur).

2. Kjo kontratë i fillon efektet e saj prej datës 1 janar 2017.

3. Palët të rakordojnë me njëra-tjetrën sasinë e energjisë së livruar me qëllim garantimin e furnizimit për klientët fundorë deri në momentin e miratimit të këtij vendimi dhe të pasqyrojnë të dhënat në tabelën e paraqitur në aneksin 1.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



Korporata
Elektroenergjetike
Shqiptare



Nr. _____ prot, datë ____/____/ 2017

Nr. _____ prot, datë ____/____/ 2017

KONTRATË PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRIVE KESH SH.A. DHE OSHEE SH.A./FSHU PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2017 - 31.12.2017

E lidhur sot më datë _____.2017, ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12728, datë 6.11.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në bllokun “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga z. Agron Hetoja, administrator i shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet “Shitësi”, dhe OSHEE sh.a./Furnizuesi i Shërbimit Universal, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 38587, datë 19.6.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën “Andon Zako Çajupi”, Pallati Conad, kati i 3, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i K72410014H, përfaqësuar nga z. Adrian Çela, administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., që më poshtë quhet “Blerësi”,

(“Palët” ose më vetë “Pala” në këtë kontratë do të referohen në cilësinë e Shitësit, Prodhuksi publik shtetëror (KESH sh.a.) dhe në cilësinë e Blerësit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike-OSHEE sh.a. në cilësinë e furnizuesit universal.)

Baza ligjore: Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimi nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 68, datë 23.6.2008, Kodi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, vendimi i bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 “Për vendosjen e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe miratimin e rregullave të detyrimit të shërbimit universal”, vendimi i bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009 “Mbi rinovimin e licencën në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 34, datë 13.5.2014 “Mbi rinovimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a., Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014 “Për licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë”, vendimi i bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 “Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, vendimi i bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016 “Mbi miratimin e licensës së prodhimit të energjisë elektrike” dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016 “Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

a) Në kushtet e reja të krijuara nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit nr. 244, datë 30.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, palët e kësaj kontrate do t’i referohen këtyre akteve, si dhe rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Bordi i ERE-s.

b) Prej sa më sipër rrjedh detyrimi i shoqërisë KESH sh.a. si prodhuesi/gjeneruesi, aksionet e të cilit kontrollohen plotësisht nga shteti, t’i shesë energji elektrike Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., i cili ka detyrimin e shërbimit publik për përmbushjen e kërkesës me energji elektrike të klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal. Kjo sasi e energjisë elektrike që do t’i shitet furnizuesit të shërbimit universal përcaktohet në këtë kontratë dhe bazohet mbi regjimin racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese të shitësit/KESH sh.a. dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit të HEC-eve të Kaskadës së Drinit në administrim të KESH sh.a.



c) Neni 99 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, përcakton që çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

Duke u bazuar mbi këtë, palët bien dakord për zbatimin e këtij vendimi në këtë kontratë të shitblerjes së energjisë.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike për furnizimin e klientëve tariforë si më poshtë vijon:

Neni 1

Subjekti i Kontratës

Kjo Kontratë (që përfshin shtojcat e saj) drejton gjithë transaksionet ku do të hyjnë Palët për blerjen, shitjen, programimin, lëvrimin dhe pranimin e energjisë elektrike për periudhën kohore 1.1.2017-31.12.2017, për furnizimin e klientëve fundorë.

Neni 2

Sasia e kontraktuar

1. Sasia e programuar/kontraktuar e prodhimit të energjisë elektrike që Shitësi do t'i lëvrojë Blerësit përcaktohet sipas vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave dhe sipas kësaj kontrate është 3 950 GWh, e cila specifikohet sipas muajve të livrimit sipas tabelës të aneksit 1, bashkëlidhur kësaj kontrate.

2. Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë totale të prodhimit deri në plotësimin e kërkesës për klientët fundorë, është i detyruar t'ia ofrojë Blerësit me çmimin e përcaktuar në këtë Kontratë.

Neni 3

Përkufizimet dhe ndërtimi

1. Përkufizimet: Termat e përdorur në Kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në shtojcën 1.

2. Interpretimi: Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për konvenciençë dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.

3. Referencat në kohë: Referencat në kohë do të jenë sipas Kohës Qendrore Europiane (CET).

4. Përputhja me aktet nënligjore dhe rregullat e tregut: Kjo Kontratë, detyrimet dhe të drejtat e Blerësit dhe Shitësit do të jenë subjekt i parashikimeve të vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Kodit të Shpërndarjes së EE, Kodeve të Rrjetit, Rregullave të Tregut, të aprovuara dhe të modifikuara kohë pas kohë nga ERE. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë është në konflikt me ndonjë parashikim të Rregullave të Tregut, atëherë do të paraprijnë këto të fundit.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

1. Shitësi do të sigurojë sasinë e energjisë elektrike të përcaktuar në nenin 2, të kësaj Kontrate, sasi e përcaktuar bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

2. Shitësi do të sigurojë sasinë e energjisë elektrike të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Kontrate, në përputhje me programet orare për ditën në avancë të Blerësit/ngarkesës për klientët fundorë, sipas përcaktimeve të Rregullave të Tregut dhe Kodeve të Rrjetit.

3. Jo më vonë se 5 ditë përpara fillimit të muajit të livrimit, në varësi të treguesve hidroenergjetikë, Shitësi do t'i rikonfirmojë Blerësit sasinë mujore për furnizimin e klientëve fundorë, sipas nenit 2 të Kontratës.

4. Shitësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e gjithë kapacitetit të kërkuar në ditën në avancë, që lidhet me kohën e dispecerimit të programit të ditës në avancë.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

1. Blerësi do t'i paraqesë shitësit programet mujore/javore/ditës në avancë me bazë orare/ngarkesës për klientët fundorë, duke iu përmbajtur sasisë së përcaktuar në nenin 2, të Kontratës dhe në përputhje me Rregullat e Tregut (Bashkëlidhur kësaj Kontrate, formatet tip që blerësi duhet t'i dërgojë shitësit për programet e muajit/javës dhe ditës në avancë.).

2. Jo më vonë se 5 ditë përpara fillimit të muajit të livrimit dhe me qëllim zbatimin e paragrafit 2, të nenit 2, Blerësi do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve fundorë për muajin përkatës.

3. Blerësi do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjithë kapacitetit të programuar, shërbimet ndihmëse, disbalancave dhe shërbimeve të transmetimit të kërkuara dhe të ofruara nga OST-ja që nga pika e livrimit, një pjesë e të cilave përcaktohen në vijim në këtë marrëveshje, sipas akteve nënligjore të miratuara nga bordi i ERE-s.

Neni 6

Detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike

1. Livrimi dhe pranim: Shitësi do të programojë, shesë dhe livrojë, ose do të bëjë të mundur të livrohet, dhe Blerësi do të programojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë të mundur të pranohet sasia e Kontratës sipas programit të deklaruar për ditën në avancë; dhe Blerësi do t'i paguajë Shitësit çmimin përkatës të Kontratës.

2. Përkufizimi i programit: "Program" sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës, dhe me OST, kur aplikohet, sasinë e Kontratës, kapacitetin e Kontratës, pikën e livrimit, programin e livrimit, periudhën totale të furnizimit dhe çdo kusht tjetër përkatës të Kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të OST-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

Neni 7

Livrimi, matja, transmetimi dhe risku

1. Rryma/frekuenca/tensionet: Energjia elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në pikën përkatëse të livrimit sipas standardeve të OST-së dhe OSHEE-së, kur aplikohet, si dhe në përputhje me rregullat dhe kodet në fuqi.

2. Programet e deklaruara: Sasia e energjisë elektrike që do të parashikohet nga Shitësi dhe përcaktohet në këtë kontratë do t'i livrohet Blerësit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe Kodin e Rrjetit. Nominimi fizik/programi për ditën e nesërme duhet paraqitur në oraret në përputhje me Rregullat e Tregut dhe kodet në fuqi.

3. Dokumentacioni i livrimeve dhe marrjeve në dorëzim: Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Pala:

a) do t'i sigurojë Palës tjetër dokumentacionin që posedon ose do të kontrollojë paraqitjen e programeve, sasive, livrimeve dhe marrjeve në dorëzim të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të kontratës individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike; dhe

b) do të bëjë përpjekjet e veta të arsyeshme dhe të zellshme për të kërkuar dhe marrë nga OST-ja dhe OSHEE-ja, kur aplikohet, dhe do të ndajë me Palën kërkuese çdo dokumentacion shtesë të nevojshëm për të sistemuar mospërputhjet/devijimet sipas përcaktimeve të nenit 9 të kësaj Kontrate.

4. Rimbursimi i kostove të jashtme: Në rast se njëra Palë, me kërkesën e Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se Pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj sipas kushteve të Kontratës, këto shpenzime do të rimbursohen me kërkesën e Palës që ka dështuar në performim.

5. Risqet e Shitësit dhe Blerësit: Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së kontratës



deri në pikën e livrimit. Blerësi do të marrë përsipër të gjitha risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur, ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të sasisë së kontratës në dhe nga pika e livrimit.

6. Pikat e livrimit: Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në hyrje te sistemit të transmetimit të OST-së, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

Neni 8

Mosperformanca për shkak të forcës madhore

1. Përkufizimi i “Forcës madhore”: Përveç se kur specifikohet ndryshe, “Forcë madhore” për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon forcën madhore (Pala Pretenduese), siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterike të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose

b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.

2. Çlirimi nga detyrimet e livrimit dhe pranimit: Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 8.3 (*Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore*), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (*Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim*) nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.

3. Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore: Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi mëson për forcën madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimit të forcës madhore do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

4. Efektet e forcës madhore mbi Palën tjetër: Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të forcës madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të forcës madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

Neni 9

Zhdëmtimet/kompensimet

9.1 Rasti i mos-performancës ana e Shitësit

1. Në atë shkallë që Shitësi - Pala që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike (Pala Livruese) nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë mujore të Kontratës sipas kushteve të pikës 1, të nenit 2, të Kontratës dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Pala Livruese do t'i paguajë Palës tjetër (Pala Pranuese) si kompensim për dëmtimet, një shumë, për sasinë e mos livruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën ndërmjet çmimit mesatar të Bursës Hungareze (HUPX) për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse (www.hupx.hu) dhe çmimit të përcaktuar në këtë Kontratë, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.

2. Shumat e pagueshme. Shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhën sipas nenit 14 (*Faturimi dhe Pagesa*).



9.2 Rasti i mosrespektimit nga ana e Blerësit

1. Në rastin kur Blerësi (Pala Pranuese) tërheq nga rrjeti më shumë energji elektrike sesa sasia e kontraktuar sipas nenit 2 (pika 1 dhe pika 2) të Kontratës dhe kur kjo sasi ka shërbyer:

- për të plotësuar kërkesën e klientëve fundorë, Blerësi është i detyruar ta paguaj këtë diferencë me çmimin e kësaj kontrate;

- për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes, Blerësi është i detyruar ta paguaj këtë diferencë me çmimin e bursës hungareze (HUPX) për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në *website*-in e kësaj burse (www.hupx.hu).

2. Në rastin kur Blerësi (Pala Pranuese) tërheq nga rrjeti më pak energji elektrike sesa sasia e kontraktuar sipas nenit 2 (pika 1 dhe pika 2) të kontratës, kjo sasi energjie do të trajtohet si e depozituar te Shitësi dhe duhet të përdoret nga Blerësi në periudhat e ardhshme deri në përfundim të kontratës.

3. Shumat e pagueshme: Shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (*Faturimi dhe pagesa*).

Neni 10

Pezullimi i livrimit

1. Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të disponueshme për një Palë (Pala që përmbush detyrimet), nëse njëra Palë (Pala që nuk përmbush detyrimet) nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontratës, ose nëse ajo ose garanti i kredisë nuk arrin ta sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e sigurisë së performancës të kërkuar sipas Kontratës ose çdo dokumenti mbështetës të kredisë, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se tri (3) ditë pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit) sipas gjithë kontratave individuale deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e zbatueshme) të gjithë shumave të papaguara që i detyrohen Palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve, apo i çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 11

Kohëzgjatja dhe të drejtat e përfundimit

1. Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga ERE. Ajo mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 12

Çmimi

1. Çmimet për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate janë përcaktuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 52, datë 6.4.2017 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.

Neni 13

Kufizimi i përgjegjësisë financiare

1. Përjashtimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 9 (Zhdëmtimet), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agjentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm (dëmet) (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një kontrate individuale) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agjentëve të saj, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontratës.



2. Dëmi pasues dhe kufizimi i përgjegjësisë financiare: Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontratës ose lidhur me të:

a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe

b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumën e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo kontrate individuale përkatëse, me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 9 (*Zhdëmtimet për paafjësini për livrim dhe pranim*).

3. Mospagesa e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore: Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:

a) mospagesën e qëllimshme;

b) mashtrimin; ose

c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.

4. Detyra për lehtësimin e humbjeve: Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë dëmet dhe premton që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo dëmi që mund të pësojë sipas Kontratës ose lidhur me të.

Neni 14

Faturimi dhe pagesa

1. Fatura: Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit për livrimin e energjisë elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe akt rakordimin përkatës.

2. Pagesa: Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës nga Blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

3. Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës konsiston në pagimin e kamatëvonesës në masën e normës së interesit të bonove të thesarit me maturim 1-vjeçar + 0.5% në vit për çdo ditë vonesë të llogaritura nga data në të cilën do të kryhej pagesa. Kamatëvonesa paguhet pa qenë i detyruar Kreditori (Shitësi) të provojë ndonjë dëm. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

4. Shumat e diskutueshme: Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

Neni 15

TVSH-ja dhe taksat

1. TVSH-ja: Të gjitha shumat e referuara në këtë Kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar (TVSH). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohej për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo Palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë Palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohej për qëllimet e Kontratës.

2. Detyrimet e taksave të Shitësit dhe Blerësit: Shitësi do të paguajë ose shkaktojë pagesën e gjithë taksave për sasinë e Kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të kryejë pagesën e gjithë taksave në sasinë e Kontratës ose lidhur me të ose të kontratës individuale që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit (përveç taksës



direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e sasisë së Kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Shitësin për këtë taksë. Në rast se Blerësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund ta zbresë shumën e kësaj takse nga shumat e detyrueshme Shitësit sipas Kontratës dhe Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Blerësin lidhur me këto taksa të pazbritura. Nëse ndonjë taksë e re bëhet e zbatueshme ose një taksë ekzistuese rritet lidhur me Kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një Pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë taksë të re ose të rritur.

3. Taksa e mbajtur: Pagesat lirë dhe qartë. Gjithë pagesat sipas një kontrate individuale do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo takse, përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një Pale i kërkohet të mbajë ose zbresë Taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë (Pala Pagueuse) do të njoftojë menjëherë Palën tjetër (Pala Marrëse) për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, Pala Pagueuse do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) Palës Marrëse.

4. Minimizimi i taksave: Të dyja Palët do të përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar Kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

Neni 16

Sigurimi i pasqyrave financiare dhe vlera neto e prekshme

1. Sigurimi i pasqyrave financiare: Përveç kur specifikohet ndryshe, nëse kërkohet nga njëra palë. Pala tjetër do t'i dorëzojë asaj:

a) brenda 180 ditëve pas mbarimit të çdo viti fiskal, një kopje të raportit vjetor që përmban pasqyra financiare të audituara dhe të konsoliduara për këtë vit fiskal, për periudhën kur detyrimi i Palës tjetër mbështetet nga Garantuesi i Kredisë ose nëse është palë e një marrëveshje kontrolli dhe transferimi të fitimit, nga Garantuesi i Kredisë ose Pala Kontrolluese, sipas rastit; dhe

b) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas përfundimit të secilit nga tre tremujorët e tij fiskalë të çdo viti fiskal, një kopje të raportit tremujor që përmban pasqyra financiare të paaudituar të konsoliduar.

2. Rënia e vlerës neto të prekshme: Sapo të bëhet e ndërjegjshme për këtë rënie, çdo Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ndodhinë e rënies të vlerës neto të prekshme ose vlerës neto të prekshme të Garantuesit të Kredisë ose Palës Kontrolluese, në një nivel nën shumën e specifikuar nga Palët.

3. Parimet financiare: Në çdo rast deklaratat financiare që referohen në pikën 17 do të përgatiten sipas parimeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Transferimi

1. Ndalimi: Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, një palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme, dhe me miratimin e ERE-s.

2. Transferimi tek filialet: Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një filiali me aftësi pagueuse të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe, me kusht që çdo dokument mbështetës kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të Palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e filialit në përfitim të Palës tjetër.

Neni 18

Përfaqësimet dhe garancitë

1. Nëse specifikohet si e zbatueshme për Palët, ajo Palë përfaqëson dhe garanton në këtë mënyrë Palën tjetër pas hyrjes në këtë Kontratë për sa vijon:



- a) se është një njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;
- b) nënshkrimi dhe hyrja në Kontratë, në çdo dokument mbështetës kredie ku është palë dhe në kryerjen e transaksioneve të shqyrtuara këtu, nuk do të shkelin asnjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese;
- c) ka pushtetin dhe është e autorizuar të ekzekutojë, shpërndajë dhe kryejë detyrimet sipas Kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë dhe ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, livrimin, kryerjen dhe hyrjen në kontratë dhe ekzekutimin, livrimin dhe kryerjen e Kontratës dhe se çdo dokument mbështetës kredie nuk shkel dhe nuk bie në konflikt me asnjë afat ose kusht tjetër të ndonjë kontrate ku është palë ose ndonjë dokument konstitucional, rregull, ligj ose rregullore në fuqi;
- d) ka gjithë autorizimet qeveritare dhe rregullatore, miratimet dhe pëlqimet e nevojshme për të kryer detyrimet sipas Kontratës dhe çdo dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë; e) ka negociuar, ka hyrë dhe ka ekzekutuar Kontratën dhe çdo dokument mbështetës kredie ku është palë si kryesore (dhe jo si agent ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe);
- e) hyn rregullisht në marrëveshje për tregtimin e energjisë elektrike siç planifikohet nga Kontrata, dhe e bën këtë mbi baza profesionale sipas linjës së vet kryesore të biznesit, dhe mund të karakterizohet në mënyrë të arsyeshme si palë profesioniste tregu;
- f) vepron për llogari të vet (dhe jo si këshilltar, agent, agent ndërmjetës ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të hyrë në këtë Kontratë dhe nëse kjo Kontratë është e përshtatshme ose si duhet për të, bazuar në gjykimin e vet, nuk mbështetet mbi këshillën ose rekomandimet e Palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është e aftë për të vlerësuar meritat dhe kupton dhe pranon afatet, kushtet dhe risqet e Kontratës;
- g) Pala tjetër nuk vepron si kujdestar apo këshilltar i saj;
- h) nuk mbështetet në asnjë përfaqësim të bërë nga Pala tjetër përveç atyre të thëna shprehimisht në Kontratë ose në dokumentin mbështetës të kredisë ku është palë;
- i) lidhur me një Palë që është njësi qeveritare ose sistem energjetik publik, kjo njësi qeveritare ose sistem energjetik publik përfaqëson dhe i garanton Palës tjetër si më poshtë:
- j) të gjitha aktet e nevojshme për ekzekutimin e vlefshëm, shpërndarjen dhe kryerjen e Kontratës, përfshirë pa kufizim, ofertat konkurruese, njoftimin publik, zgjedhjen, referendumin, përvetësimin paraprak ose procedura të tjera të kërkuara që janë ndërmarrë ose kryer ose do të ndërmerren dhe kryhen;
- k) hyrja në Kontratë dhe zbatimi i saj nga një njësi qeveritare ose sistem energjetik publik bëhet për një qëllim të duhur publik brenda kuptimit të dokumenteve përkatëse konstitucionale ose qeveritare dhe legjislacioni në fuqi; dhe
- l) afati i Kontratës nuk zgjatet përtej ndonjë kufizimi të zbatueshëm të vendosur nga ndonjë dokument tjetër përkatës konstitucional ose qeveritar dhe nga legjislacioni në fuqi; dhe
- m) lidhur me një Palë, se nuk ka falimentuar, dhe nuk ka procedime ligjore ose administrative pezull ose kërcënuese ku të jetë palë dhe që në dijeni të saj do të ndikojnë materialisht në mënyrë të dëmshme aftësinë e saj për kryerjen e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate ose ndonjë dokumenti mbështetës të kredisë ku është palë, të tilla që ta bëjnë të falimentonte.

Neni 19

Personat e kontaktit

1. Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me *e-mail* ose faks:



Për OSHEE/FSHU	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj _____ Funksioni Adresa....., Tiranë Tel.: + 355 Mob:+ 355 Fax: + 355 E-mail: @kesh.a.l	Z/Znj _____ Funksioni Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel: + 355 42 241 982 Mob:+ 355 69 Fax: + 355 42 241 982 Email: @kesh.a.l
Programimi	
Z/Znj _____ Funksioni Adresa....., Tiranë Tel: + 355 Mob:+ 355 Fax: + 355 Email: @kesh.a.l.l	Z/Znj _____ Funksioni Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel: + 355 42 241 982 Mob:+ 355 69 Fax: + 355 42 241 982 Email: @kesh.a.l
Back Office	
Funksioni Adresa....., Tiranë Tel: + 355 Mob:+ 355 Fax: + 355 Email: @kesh.a.l	Z/Znj _____ Funksioni Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë Tel: + 355 42 241 982 Mob:+ 355 69 Fax: + 355 42 241 982 Email: @kesh.a.l

Neni 20

Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH-së.
2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontratën do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga gjykata të të drejtave të saj kontraktuale.

Neni 21

Të ndryshme

1. Regjistrimi i bisedave telefonike: Çdo palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura lidhur me Kontratën dhe t'i përdorë si provë. Çdo palë heq dorë nga çdo njoftim tjetër mbi këtë regjistrim dhe pranon se ka marrë gjithë pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të vet për këto regjistrime.
2. Njoftimet dhe komunikimet: Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, të gjitha njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrin brenda 24 orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - a) nëse shpërndahen dorazi ditën e punës, ose ditën e parë të punës pas datës së livrimit nëse shpërndahen jo në ditën e punës;
 - b) nëse dërgohen me postë të klasit të parë, ditën e 2-të të punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në ditën e 5-të të punës pas datës së postimit;



c) nëse dërgohen me transmetim faksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në ditën e punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në ditën e parë të punës pas transmetimit.

3. Amendimet: Çdo amendim ose shtesë në këtë kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

4. Pavlefshmëria e pjesshme: Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Palët ndërmarrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit nga ERE.

5. Të drejtat e Palës së Tretë: Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë Kontratën dhe Palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.

Neni 22

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga bordi i ERE dhe i shtrinë efektet për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017.

2. Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 23

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme, 2 (dy) për secilën palë.



Korporata
Elektroenergjetike
Shqiptare



Agron Hetoja

ADMINISTRATORI I KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE
SHQIPTARE

Adrian Cela

ADMINISTRATORI I OPERATORIT
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE

*Shtojca 1 e Kontratës, termat e përcaktuar*

Termat e përdorur në Kontratë do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Pala Pranuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9.1 (Paaftësia për livrim) të kësaj Kontrate.

“Filial” lidhur me një Palë do të thotë një njësi e kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo njësi që kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo njësi direkt ose indirekt nën kontrollin e përbashkët të një Pale.

“Kontratë” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (Subjekti i Kontratës).

“Çmimi referues alternativ i mallit” ka kuptimin, nëse ekziston, të specifikuar në çdo kontratë individuale që përmban një çmim të paqëndrueshëm.

“Dita e punës” do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar.

“Blerës” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale.

“Disbalanca” është diferenca midis fluksit të energjisë elektrike të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe (nominimi fizik i programit për ditën në avancë) dhe fluksit aktual të matur të energjisë, për një orë të caktuar.

“Përgjegjësia për balancimin”, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

“Data e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm.

“Metoda e llogaritjes” ka kuptimin e specifikuar në kontratën individuale të çmimit të paqëndrueshëm.

“Koha qendrore evropiane” ose “CET” do të thotë koha qendrore evropiane dhe do të përfshijë kohën dimërore qendrore evropiane dhe kohën verore qendrore evropiane sipas zbatimit.

“Konfirmimi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 3.2 (Konfirmimet).

“Kapaciteti i Kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MWh.

“Çmimi i Kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, çmimi i vendosur mes Palëve;

“Sasia e Kontratës” lidhur me një kontratë individuale do të thotë, sasia e vendosur mes Palëve, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, e shprehur në MWh.

“Kontroll” do të thotë pronësia e më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të fuqisë votuese të një Pale ose njësie;

“Vlerësimi i Kredisë” lidhur me një njësi do të thotë sa më poshtë: i) vlerësimi afatgjatë i pasiguruar, i pavarur i borxhit publik (i pambështetur nga vlerësimi i kredisë së palës së tretë); ii) vlerësimi i kredisë të nxjerrësit të borxhit; ose iii) vlerësimi i kredisë së korporatës që i është dhënë asaj njësie, në secilin rast “i” deri “iii” nga Grupi i Vlerësimit Standard & dhe të Varfër (divizion i McGraw-Hill Inc.) ose Moody's Investor Services Inc.

“Dokumentet mbështetës të kredisë” ka kuptimin e specifikuar, që mund të përfshijë, pa kufizim, një garantues, garanci bankare, letër ndërgjegjësimi, letër kredie ose çdo marrëveshje për mbështetje kredie.

“Garantuesi i Kredisë” ka kuptimin e specifikuar lidhur me një Palë të specifikuar.

“Shtojca ndërkufitare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 21(k) (Përfaqësimet dhe garancitë).

“Dëmet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 12.2 (Përfshirja e përgjegjësiave financiare);

“Pala që nuk përmbush detyrimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9.1 (Pezullimi i livrimit).

“Pala livruese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9.1 (Paaftësia livruese);

“Pika e livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve;

“Programi i livrimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve për ditën në avancë sipas rregullave përkatëse;

“Data e pagesës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.2 (Pagesa);

“EBIT” do të thotë fitimet para interesit dhe taksave që, lidhur me vitin përkatës fiskal, do të jenë të ardhurat neto të njësisë përkatëse para zbritjes së taksave të fitimit (ose çdo takse tjetër mbi të ardhurat ose fitimet në C juridiksionin përkatës të njësisë përkatëse); plus shumën e gjithë interesave dhe çdo



shumë në natyrën e interesit që u ngarkohet shpenzimeve që lidhen me detyrimin financiar për paratë e marra borxh (shuma që përfshijnë borxhet e pagueshme filialeve, si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Kosto reale” ka kuptimin e të gjitha shpenzimeve që identifikohen nga kompania për sigurimin e energjisë elektrike nga burimet përkatëse përfshirë edhe gjithë kostot shtesë të paparashikuara (*overdraft*) si dhe çdo vlerësim mbi impaktin e transaksionit në treguesit e eficiencës së përdorimit të rezervave ujore;

“Data e hyrjes në fuqi” ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate.

“Njësia” do të thotë një individ, qeveri ose shtet ose divizion, agjenci qeveritare ose shtetërore, korporatë, partneritet ose ndonjë njësi tjetër siç mund ta kërkojë konteksti.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, ose çdo organizatë pasuese me autoritet të krahasueshëm mbi tarifën, afatet dhe kushtet e energjisë elektrike.

“Forca madhore” ka kuptimin e specifikuar në pikën 7.1 (Përcaktimi i forcës madhore).

“Fondet nga operimi” do të thotë shuma në *cash* e gjeneruar ose e përdorur nga njësi përkatëse për aktivitetet e saj operuese.

“Fitimet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(b) (Shuma e Marrëveshjes Financiare).

“Mbajtës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (Livrimi dhe pranimi sipas një opsioni).

“Përqindja e interesit” ka kuptimin e specifikuar në pikën 4.1 të nenit 13 (Interesi i mospagesës);

“Kontrata individuale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 1.1 (subjekti i Kontratës);

“Letra e Kredisë” do të thotë një letër e parevokueshme garancie për kredinë e pagueshme me kërkesë sipas formës dhe përmbajtjes së pëlqyeshme nga Pala Kërkuese dhe që nxirret nga një institucion financiar tarifa e Kredisë së të cilit është të paktën tarifa e specifikuar nga palët (tarifa e Kredisë së siguresit mbështetës të kredisë që është bankë);

“Humbjet” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2(c) (Shuma e Marrëveshjes Financiare);

“Ndryshimi i dëmshëm material” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (ndryshimi i dëmshëm material);

“Arsyeja Materiale” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.5 (Përkufizimi i Arsyes Materiale);

“Pala që përmbush detyrimet Jo-Mospaguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 9 (Pezullimi i Livrimit);

“Përfundimi i Zakonshëm” ka kuptimin e specifikuar në pikën 10.2 (Data e mbarimit të afatit dhe njoftimi 30-ditor i përfundimit);

“OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit.

“OSHEE” do të thotë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

“Pala Paguese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (Pagesat Lirë dhe Qartë).

“Siguria e Performancës” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (Siguria e Performancës).

“Pala Marrëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.3(a) (Pagesat Lirë dhe Qartë).

“Njësia Përkatëse” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.2 (a) (Vlerësimi i Kredisë).

“Pala Kërkuese” ka kuptimin e specifikuar në pikën 17.1 (Vlerësimi i Kredisë).

“Programi” ka kuptimin e specifikuar në pikën 4.2 dhe 5.2 (Përkufizimi i programit) dhe “I Programuar” dhe

“Programimi” do të interpretohen sipas kësaj;

“Shitës” ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

“Shuma e Marrëveshjes Financiare” ka kuptimin e specifikuar në pikën 11.2 (Shuma e Marrëveshjes Financiare);

“Data e Marrëveshjes Financiare” ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

“Çmimi i Marrëveshjes Financiare” ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

“Detyrimi i specifikuar” do të thotë çdo detyrim financiar (aktual ose i ardhshëm, i paparashikuar ose ndryshe, si principal ose garanci ose ndryshe) për paratë e marra borxh (që përfshijnë borxhet e pagueshme të Filialeve si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare);



“Vlera neto e preکشme” do të thotë shuma e gjithë kontributeve të paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose në ndonjë llogari tjetër kapitali të njësisë përkatëse e vendosur për qëllimet e njësisë përkatëse dhe çdo fitim i akumuluar pa humbjet e mbajtura të akumuluar dhe asetet e preکشme, përfshirë, por pa u kufizuar me klientelën;

“Taksë” do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjobat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontratës përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;

“Kapitalizimi total” lidhur me periudhën përkatëse do të thotë shuma e borxhit total dhe gjithë kontributet e paguara në *cash* të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose ndonjë llogari tjetër kapitali që vendoset për qëllimet e Njesisë Përkatëse;

“Borxhi total” lidhur me periudhën përkatëse, do të thotë shuma e detyrimit financiar për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet që u paguhen kompanive filiale, si dhe instrumentet e borxhit të institucioneve financiare) të njësisë përkatëse;

“Periudha totale e furnizimit” lidhur me një kontratë individuale do të thotë periudha e furnizimit e vendosur mes Palëve;

“TVSH” ka kuptimin e specifikuar në pikën 14.1 (TVSH);

“Shkrues” ka kuptimin e specifikuar në pikën 5.1 (Livrimi dhe pranimi sipas një opsiioni).

ANEKSI I

PARASHIKIMI I PRODHIMIT NGA KESH sh.a PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2017

- Regjimi për prodhim
kontraktual (shfrytëzim racional)

Treguesit	Njesia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Viti 2017
Shfrytëzimi Janar-Dhjetor 2017	Prurja Fierze, me 75% sig.	m ³ /sek												
	Niveli në Fierze në fillim	m												
	Niveli në Fierze në fund	m												
	Prodhimi bruto KESH GEN	GWh												
	KESH Gen per FSHU	GWh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3950



ANEKSI 2:

OSHEE

PROGRAMI MUJOR I KERKESËS SE KLIENËVE FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL I FURNIZIMIT PËR ENERGIJË ELEKTRIKE

MUJ: 2017

ORA \ DATA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Prograshi i kërkesës për energji elektrike për muajt 2017 (MWh)
Kërkesa mujore (MWh)																																
01.00																																
02.00																																
03.00																																
04.00																																
05.00																																
06.00																																
07.00																																
08.00																																
09.00																																
10.00																																
11.00																																
12.00																																
13.00																																
14.00																																
15.00																																
16.00																																
17.00																																
18.00																																
19.00																																
20.00																																
21.00																																
22.00																																
23.00																																
24.00																																

OSHEE

PROGRAMI JAVOR I KERKESËS SE KLIENËVE FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL I FURNIZIMIT PËR ENERGIJË ELEKTRIKE

ORA \ DATA	1	2	3	4	5	6	7	Prograshi i kërkesës për energji elektrike për muajt 2017 (MWh)
Kërkesa javore (MWh)								
01.00								
02.00								
03.00								
04.00								
05.00								
06.00								
07.00								
08.00								
09.00								
10.00								
11.00								
12.00								
13.00								
14.00								
15.00								
16.00								
17.00								
18.00								
19.00								
20.00								
21.00								
22.00								
23.00								
24.00								

OSHEE

PROGRAMI DITOR I KERKESËS SE KLIENËVE FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL I FURNIZIMIT PËR ENERGIJË ELEKTRIKE

MUJ: 2017

ORA \ DATA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Prograshi i kërkesës për energji elektrike për muajt 2017 (MWh)
Kërkesa ditore (MWh)																																
01.00																																
02.00																																
03.00																																
04.00																																
05.00																																
06.00																																
07.00																																
08.00																																
09.00																																
10.00																																
11.00																																
12.00																																
13.00																																
14.00																																
15.00																																
16.00																																
17.00																																
18.00																																
19.00																																
20.00																																
21.00																																
22.00																																
23.00																																
24.00																																



VENDIM
Nr. 63, datë 11.5.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
PËR PJESËMARRJEN NË TREGUN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit II, pika II.2.4 të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s; nr. 139, datë 25.8.2016, të ndryshuar, dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftmarrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Kjo Marrëveshje hartohet në zbatim të kapitullit II, pika II 2.4 të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016.

- Me shkresën nr. 6583 Prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Draftmarrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”.

- ERE me vendimin nr. 2, datë 19.1.2017, filloi procedurat për miratimin e “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”.

- ERE me shkresën nr. 89 Prot., në datë 26.1.2017, ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me draftmarrëveshjen për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike.

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën me nr. 31/1 Prot., datë 23.2.2017, ka përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet e saj në lidhje me draftmarrëveshjen për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

a) Të miratojë “Draftmarrëveshjen për pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike”.

b) Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., KESH sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetin e

Konkurrencës, MEI dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

MARRËVESHJA
PËR PJESËMARRJEN NË TREG
MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE NR. 63, DATË 11.5.2017

Marrëveshja për pjesëmarrje në tregun e energjisë elektrike nënshkruhet sot më datë _____ midis Palëve:

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit-Operatori i Tregut (OST-OT), i regjistruar në Regjistrin Tregtar (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit) me vendimin nr. 31935, datë 14.7.2004 dhe seli në _____, i përfaqësuar nga z. Engjëll Zeqo, këtu e më poshtë i quajtur OST – OT.

- Pjesëmarrësi në tregun e energjisë elektrike, i regjistruar në _____ me nr. _____ dhe seli në _____, i përfaqësuar nga _____, këtu e më poshtë i quajtur _____.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1 OST sh.a. në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 53, pika 1, është mbajtës i vetëm i licencës për transmetimin e energjisë elektrike, të dhënë nga ERE me vendimin nr. 24 datë 26.3.2009.

Në bazë të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, Kapitulli II, pika 2.4, të miratuara me Vendimin nr. 139, datë 15.8.2016 të Bordit të ERE-s, një ndër funksionet e OST sh.a., është ai i operatorit të tregut.

1.2 (Pjesëmarrësi i tregut, Palë e kësaj kontrate) _____ në përputhje me nenin 37, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, është mbajtës i Licencës për



_____, të dhënë nga ERE me vendimin nr. _____ datë ____/____/____.

Në bazë të Kapitulli II të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016 të bordit të ERE-s (Pjesëmarrësi i Tregut, Palë e kësaj kontrate) _____, ka funksionin e _____ (sipas aktivitetit të licencuar) në tregun shqiptar të energjisë elektrike.

KAPITULLI II QËLLIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

2.1 Kjo marrëveshje rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve që e nënshkruajnë atë, OST-OT dhe pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga veprimtaria e tyre në tregun e energjisë.

KAPITULLI III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 3

3.1 Palët, bien dakord të pranojnë rolin dhe funksionin përkatës të tyre në tregun e energjisë elektrike, dhe angazhohen të zbatojnë me kujdesin e duhur ligjet, kodet, rregullat dhe praktikatat tregtare që rregullojnë ose kanë të bëjnë me sektorin e energjisë elektrike dhe tregun e energjisë elektrike.

3.2 Palët, bien dakord të ndërtojnë dhe zbatojnë marrëveshje dhe kontrata me pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në përputhje me Rregullat e Tregut.

3.3 Palët, bien dakord të shkëmbejnë informacione dhe të dhëna në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse për informim në përputhje me Rregullat e Tregut.

3.4 Palët marrin përsipër të përmbushin detyrimet financiare përkatëse në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Marrëveshjet dypalëshe të lidhura në përputhje me to. Në çdo rast Palët nuk do të ndërmarrin kompensimin e ndërsjellë të detyrimeve pa rakordimin dhe miratimin e palës tjetër.

KAPITULLI IV PJESËMARRËSI NË TREG

Neni 4

4.1 Pjesëmarrësi në treg bie dakord që t'u përmbahet në çdo kohë Rregullave të Tregut, gjithë kodeve teknike shoqëruese, dhe procedurave të brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

4.2 Të gjitha aktet e brendshme të OST – OT sipas pikës 4.1, të cilat pjesëmarrësi do të duhet t'i zbatojë, do të vendosin detyrime të cilat nuk i tejkalojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e energjisë elektrike dhe në aktet e nxjerra nga ERE.

Neni 5

5.1 Pjesëmarrësi në treg është i detyruar të informojë OST – OT në lidhje me çdo kontratë të lidhur. Ai duhet të dorëzojë në OST – OT informacion për çdo kontratë, duke identifikuar si më poshtë:

- i) Identifikimin e palëve të kontraktuara;
- ii) Pikat e livrimit/tërheqjes;
- iii) Kohëzgjatjen e kontratës;
- iv) Sasitë e kontraktuara.

Këto kërkesa do të zbatohen për të gjithë kontratat dypalëshe, përshirë kontratat për eksport/import.

5.2 Kontrata e lidhur ndërmjet dy pjesëmarrësve në treg, bëhet efektive pasi OST – OT të ketë konfirmuar marrjen e saj. OST – OT duhet të konfirmojë marrjen e një kontrate të tillë brenda jo më vonë se 10 ditë pune. Mungesa e konfirmimit brenda këtij afati e bën efektive kontratën.

Neni 6

Pjesëmarrësi në treg duhet të dorëzojë tek OST – OT njoftimet lidhur me gjithë shkëmbimet fizike neto mes palëve individuale (njoftime kontraktuale) ose ndërmjet palëve përgjegjëse për balancimin, me qëllim realizimin fizik të detyrimeve kontraktuale.

Neni 7

7.1 Pjesëmarrësi në treg do t'i paraqesë OST një program ditor në përputhje me procesin e programimit të ditës në avancë, siç specifikohet



në Kodin e Rrjetit, me qëllim që OST të përcaktojë formatin e programit ditor.

7.2 Forma dhe mënyra e paraqitjes së programit ditor dhe procedurat e tjera ndihmëse janë objekt i përcaktimit të OST sh.a. në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut.

Neni 8

8.1 Pjesëmarrësi në treg do të marrë përgjegjësi për balancimin përkundrejt OST për gjithë prodhimin, blerjen, importin, eksportin, shitjen ose konsumin e tij.

8.2 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me Rregullat e Tregut. Në rast se kjo balancë nuk ofrohet dhe për çdo mos realizim në kohë, substancë dhe formë të detyrimeve që rrjedhin nga Rregullat e Tregut dhe kjo marrëveshje, nga pala përgjegjëse, pjesëmarrësi mund të kërkojë shpërblim.

8.3 Deri në krijimin e tregut të balancimit, tarifat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE. Kjo metodologji duhet të reflektojë kostot dhe bëhet publike.

8.4 Atje ku Rregullat e Tregut nuk e përcaktojnë, përgjegjësia do të nxirret në bazë të Kodit Civil.

KAPITULLI V OST – OT

Neni 9

9.1 OST- OT, ka të drejtë të kërkojë nga pjesëmarrësi i tregut të gjithë informacionin e nevojshëm, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe kodet teknike shoqëruese, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Neni 10

10.1 OST - OT është e detyruar të përdorë informacionin e siguruar nga pjesëmarrësi i

tregut, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe kodet teknike shoqëruese, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Neni 11

11.1 OST - OT do t'i bëjë të disponueshme çdo pjesëmarrësi në treg çdo informacion lidhur me operimin e tregut të energjisë elektrike të papërcaktuar si konfidencial ose komercialisht të ndjeshëm.

Përfundimisht përcaktimet e 11.1, dhe vetëm në interesin dhe funksionin publik që rrjedh nga veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), OST-OT do t'i japë OSSH-së dhe FSHU-së të dhëna që këto operatorë (d.m.th. OSSH dhe FSHU) dhe mund të kërkojnë për mbarëvajtjen e shërbimeve të tyre.

KAPITULLI VI HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA /PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

Neni 12

12.1 Nënshkrimi i kësaj marrëveshje është kusht për pjesëmarrje në tregun e energjisë elektrike. Nënshkrimi do të bëhet vetëm nga persona të cilët janë të autorizuar drejtpërdrejtë në bazë të legjislacionit shqiptar apo me prokurë për të përfaqësuar secilën palë.

12.2 Kjo marrëveshje bëhet efektive dhe e detyrueshme për Palët në datën e zbatimit të saj.

12.3 Kjo marrëveshje është pa afat dhe Pjesëmarrësi mund ta zgjidh duke i dhënë njoftim paraprak OST-OT. OST-OT nga ana e saj mund ta zgjidh marrëveshjen vetëm për arsye të mbështetura dhe vetëm pas miratimit të ERE.

Neni 13

Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi. Njoftimi duhet paraqitur të paktën 3 muaj para datës kur duhet anuluar regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut dhe duhet përfunduar marrëveshja. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-ja do të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.



Neni 14

Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e Rregullave të Tregut atëherë pjesëmarrësi ose OST-OT duhet të informojnë ERE-n brenda 10 ditë pune nga konstatimi për kushtet.

Neni 15

OST-OT do të pezullojë veprimtaritë tregtare të pjesëmarrësve nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrim si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike);

- Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare ose nuk bën pagesat e tjera (të parashikuara në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike);

- Pjesëmarrësi i tregut nuk respekton Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg;

- Pjesëmarrësi i tregut gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike ose marrëveshjen financiare.

Neni 16

Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun (shkaqet) që shkaktoi pezullimin e tij, gjatë periudhës së specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-OT do të procedojë me përfundimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg.

Nëse ky vendim i OST-OT kundërshtohet nga pjesëmarrësi atëherë pas paraqitjes së ankesës, ERE do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do të marrë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e ankesës.

Paraqitja në ERE e ankesës nga pjesëmarrësi i tregut, pezullon zbatimin e vendimit të OST sh.a. deri në marrjen e vendimit nga ERE.

Neni 17

Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (të reja) të pjesëmarrësit të tregut do të

anulohen automatikisht për gjithë periudhën e pezullimit.

Neni 18

18.1 OST-OT do ta përfundojë Marrëveshjen për Pjesëmarrje në Treg të një pjesëmarrësi tregu në secilin nga këto raste:

- a) Nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më një ose disa nga kushtet e nevojshme për regjistrimin si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike);

- b) Nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare (siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike);

- c) Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg;

- d) Nëse pjesëmarrësi në treg gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike.

18.2 Marrëveshja për pjesëmarrjen në treg do të revokohet automatikisht dhe menjëherë, kur pjesëmarrësit në treg i hiqet licenca nga ERE.

Neni 19

Mosmarrëveshjet mes palëve që nuk janë arritur të zgjidhen në mënyrë miqësore do të lihen në kompetencën e ERE për t'u gjykuar. ERE do të marrë vendimin e saj brenda 15 ditëve pune nga marrja e ankesës. Pavarësisht vendimit të ERE-s dhe pas arritjes së këtij vendimi, Palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për shqyrtimin gjyqësor të konflikteve. Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata Administrative.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri kopje, një për pjesëmarrësin në treg dhe dy për OST – OT.

Forma e kësaj marrëveshje është miratuar nga ERE si “Marrëveshja për Pjesëmarrjen në Treg”, me _____ vendimin _____ nr. _____ datë ____/____/____

Operatori i Sistemit të Transmetimit

Pjesëmarrësi në Treg

**VENDIM****Nr. 64, datë 11.5.2017****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
DISA NDRYSHIME NË
MARRËVESHJEN E SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA DHE
FURNIZUESIT MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 23,
DATË 15.2.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pika 4 e VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s mbi propozimin e OST sh.a., depozituar në ERE me shkresën nr. 2933 Prot datë 7.4.2017 për disa ndryshime në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 65, datë 11.5.2017****PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “ALB ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 31.3.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,



VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Alb Energy” sh.p.k. , në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 66, datë 11.5.2017

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR
LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
SHOQËRISË “ALB ENERGY” SHPK, NË
FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënie peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 56, datë 18.4.2017, ka filluar procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënie peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga Faqe| 6418

ERE në “rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat:

- “a” - ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;

- “b” - veprimtaria e licencuar, është plotësuar;

- “c” - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është plotësuar;

- “d” - përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;

- “e” - arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;

- “f” - efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;

- “g” - efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;

- “h” - marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja përmban një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;

- “i” - deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;

- “j” (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt) është plotësuar;

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k. , për lënie peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a. (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

**ASETET QË SHOQËRIA “ALB ENERGY”
SH.P.K. KA KËRKUAR TË LËRË PENG NË
FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA**

a) Certifikatë nr. 548628; përshkrimi i pasurisë:
Hec “BELE 2” disponon ndërtesën me $S = 609$
 m^2 ,

Tubacion 1502 m

Vepra e marrjes sip=235 m^2

Sipërfaqe truall $= 16.594 m^2$,

b) Certifikatë nr. 548626; përshkrimi i pasurisë:
“Hec Topojan 1” disponon ndërtesën $S = 372$
 m^2 ,

Tubacion 1502m

Sipërfaqe truall, $S = 4641 m^2$,

c) Certifikatë nr. 548650; përshkrimi i pasurisë:
Nënstacion, $S = 932 m^2$

VENDIM

Nr. 67, datë 11.5.2017

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BALKAN GREEN ENERGY” SHPK, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1 germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për

licencimin e shoqërisë Balkan Green Energy sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Balkan Green Energy sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë të pjesshme.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b” janë plotësuar; germat “c” dhe “d” të pa plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është i paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë Balkan Green Energy sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**



VENDIM

Nr. 68, datë 11.5.2017

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK
NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1 germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b” të plotësuar; germat “c” dhe “d” të paplotësura.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është i paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërinë Albanian Green Energy sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 69, datë 11.5.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “KURUM
INTERNATIONAL” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Kurum International sh.a. për rinovimin e licencës, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën nr. 31 Prot., datë 6.4.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për rinovimin e licencës së furnizimit me energji elektrike.

2. Shoqëria HEC “Ulëz - Shkopet” sh.a. është pajisur me licencën e furnizuesit të kualifikuar me



vendimin nr. 106, datë 20.7.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe shoqëria HEC “Bistrica 1” sh.a., “Bistrica 2” sh.a. me vendimin nr. 110, datë 31.7.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Afati për të dy këto licenca përfundon respektivisht në datat 20.7.2017 dhe 31.7.2017.

3. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, ka miratuar transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga shoqëritë HEC “Ulëz – Shkopet” sh.a. dhe HEC “Bistrica 1”, “Bistrica 2” sh.a., te shoqëria “Kurum International” sh.a.

4. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 98, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, ka përcaktuar se: Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar, shtrihen për gjithë periudhën e mbetur të kohës në licencën aktuale.

5. Kërkesa e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vjen brenda afatit të përcaktuar në nenin 16 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për sa më sipër nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Kurum International” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7/1 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a. në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 70, datë 11.5.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI UNIVERS” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “d”, 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5, germa “e”, 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përkatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energji Univers” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 71, datë 11.5.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 176, SERIA T12 TË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1 germa “e”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit

Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për rinovimin licencës së shoqërisë Danske Commodities Albania sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gjerat “a”, është plotësuar tërësisht. Subjekti ka paraqitur në ERE vërtetimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të datës 19.04.2017, në të cilin thuhet se kjo shoqëri nuk ka detyrime tatimore për tatimin mbi fitimin, kontribute të sigurimeve shoqërore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi, tatim të mbajtur në burim.

- Neni 9, pika 3, gjerat “b”, “c”, “d”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 72, datë 11.5.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “PPC
ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1 germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “PPC Albania” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat “a”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 3, germa, “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit) shoqëria “PPC Albania” sh.a., nuk ka ushtruar më parë aktivitetet.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 73, datë 16.5.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“CGC” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 107, të nenit 22 pika 2 germa “ç”, të nenit 83 pika 1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, nenit 4, pika 1, germa “ç”; nenit 10 dhe 11 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.5.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “CGC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit të shoqërisë “CGC” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni ligjor (neni 9, pika 1, germa “d/i”, “d/ii” (akti i regjistrimit dhe struktura organizative) janë plotësuar në mënyre korrekte,

- Germa “e/vii” (garanci e performancës) është plotësuar.

- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “e/i”, “e/ii”, sasia e gazit në Nm³ dhe garancia e cilësisë së gazit) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9 pika 2 germa “e/iii” garancia financiare) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë CGC sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 2276/5, datë 25.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të

përhershëm të kalimit, për pasuritë e paluajtshme që preken nga ndërtimi i Korridorit të Ndërtimit (pjesa e dytë), Sistemit të Gazsjellësit (pjesa e dytë) në zonat Korçë, Devoll, Berat, Skrapar, pjesë e projektit TAP. Subjekti kërkues i kësaj kërkesë është Trans Adriatic Pipeline AG Shqipëri, shoqëri e cila do zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim sipas listave emërore bashkëlidhur, mbi masën e vlerësimit të llogaritur në zbatim të Ligjit të Posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me Planin e Rehabilitimit të Jetesës. Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, si dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Koli Bele



TABELA 1
LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK.	Nr. pas	Lloji pas.	Sip. m ² për marrje në përdorim të përkohshëm	Çmimi / m ²	Vlera, lekë	Sip.m ² Servitut	Çmimi /m ²	Vlera, lekë	Vlera totale e kulturave	Objekte, vlera lekë	Toka Jetime vlera, lekë	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
1	Petrit	Reshat	Xhizdari	2739	207	Kullotë	-	69.8		410.00	101	41,271.42	17,425.00			58,696.42	K-34-125-(135-B)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Muharrem	Reshat	Xhizdari															
	Beqir	Reshat	Xhizdari															
	Ferdinant	Reshat	Xhizdari															
	Lavdiqe	Reshat	Xhizdari															
	Drita	Reshat	Xhizdari															
	Tomorr	Hajri	Shurdhi															
	Leonora	Hajri	Muabelliu															
Albana	Hajri	Shurdhi																
2	Pellumb	Sheme	Sulka	2739	130/3	Arë	223.00	69.8	15,554.25	44.00	140	6,138.00	540,747.27			562,439.52	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
3	Baki	Ferit	Caushi	2739	196/3	Truall	31.00	109.8	3,402.25	-	220	0.00	372.00			3,774.25	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
4	Daut	Iljaz	Ymeri	2739	130/31	Arë	39.00	69.8	2,720.25	-	140	0.00	48,590.50			51,310.75	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se sipas AMTP lloji pasurise është pemtore.
5	Maria	Rusha n	Sulka	2739	130/5	Arë	92.00	69.8	6,417.00	66.00	140	9,207.00				15,624.00	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Faik		Sulka								164,230.40		164,230.40					
6	Maria	Rusha n	Sulka	2739	130/6	Arë	142.00	69.8	9,904.50	47.00	140	6,556.50				16,461.00	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Feti		Sulka								87,380.52		87,380.52					
7	Maria	Rusha n	Sulka	2739	130/7	Arë	400.00	69.8	27,900.00	-	140	0.00				27,900.00	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Feti		Sulka								274,286.00		274,286.00					
8	Krenar	Hetem	Sulka	2739	130/2	Arë	38.00	69.8	2,650.50	-	140	0.00	43,294.26			45,944.76	K-34-125-(119-C)	ZVRPP Konfirmon se sipas AMTP lloji pasurise është pemtore.
9	Pellumb	Sheme	Sulka	2739	130/4	Arë	355.00	69.8	24,761.25	310.00	140	43,245.00				68,006.25	K-34-125-(119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Maria	Rusha n	Sulka	2739	130/9	Arë	223.00	69.8	15,554.25	-	140	0.00				15,554.25	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Feti		Sulka								128,727.00		128,727.00					
11	Dajlan	Rahma n	Seitaj	1420	1/19	Truall	775.00	175.0	135,625.00	344.00	630	216,720.00	9,300.00	16,208,116.64		16,569,761.64	CO-H-2	ZVRPP konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative për llogari të Bankës së Kursimeve.
	Ardian	Shaqir	Caka															
12	Ferdinand	Servet	Cerri	1420	1/4 N1	Njesi	57.00	175.0	9,975.00	-	630	0.00	684.00	895,848.20		906,507.20	CO-H-1	ZVRPP konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative për llogari të Agjencisë së Trajtimt të Kredive
13	Flamur	Novru s	Xhaferllari	1420	1/4 N2	Njesi	563.00	175.0	98,525.00	223.00	630	140,490.00	6,756.00	8,851,253.80		9,097,024.80	CO-H-1	
14	Flamur	Nevrus	Xhaferllari	1420	1/70	Arë	53.00	69.8	3,696.75	6.00	140	837.00	10,136.00			14,669.75	CO-H-1	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
15	Sazan	Jakup	Satka	1420	1/21	Njesi	251.00	175.0	43,925.00	-		0.00	3,012.00			56,000.00	CO-H-2	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	Fejzo	Jakup	Satka															
	Xhevit	Sokol	Hyseini															
	Shoqeria “ALB KALUSTYAN” sh.p.k.																	
16	Kastriot	Xhevit	Selimi	1420	1/67	Truall	450.00	175.0	78,750.00	61.00	630	38,430.00	5,400.00			122,580.00	CO-H-2	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
17	Flamur	Novrus	Xhaferllari	1420	1/5	Truall	208.00	175.0	36,400.00	-			2,496.00			38,896.00	CO- H 4	ZVRPP konfirmon se pasuria ka kufizim
	TOTALI						3,900.00		515,761.00	1,511.00		502,894.92	1,342,836.95	25,955,218.64	0.00	28,325,774.51		



TABELA NR. 2
RRETHI: SKRAPAR
LISTA E PËRDORUESVE TË PASURIVE NË PRONËSI TË SHTETIT

Nr.	Pronari	Rrethi	ZK.	Nr. pas.	Lloji pas.	Vlera totale e kulturave	Objekte, vlera lekë	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Përdoruesi i cili likuidohet vetëm për vlerën e kulturave dhe/ose objektit
1	Shtet	Skrapar	1420	17/9	Arë	136,222.28		136,222.28	CO-I-3	Avni Myzyri
	TOTALI					136,222.28	0.00	136,222.28		

TABELA NR. 3
RRETHET: KORÇË, DEVOLL, BERAT
LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT ME QIRA PËR 1 VIT

Nr.	Pronari/Përdoruesi			ZK.	Nr. pas.	Lloji pas.	Sip. m ² për marrje në përdorim të përkohshëm	Çmimi/m ²	Vlera, lekë	Vlera totale e kulturave	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
1	Arben	Ali	Beqe	3660	64/2	Arë	15.00	97.3	1,458.75		56,000.00	K-34-126-(40-B)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Ilirian		Skenderas							165.00	165.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
2	Idaet	Shaban	Hasankolli	1631	17	Arë	193.00	63.1	12,183.13	1,061.50	13,244.63	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Sali	Hysen	Elezi	1631	12/1	Arë	530.00	63.1	33,456.25		33,456.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Pilo	Nikolla	Zguri	3668	281/48	Arë	163.00	80.8	13,162.25	978.00	56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Dhimiter		Binjaku	3668	281/45	Arë	23.00	41.3	948.75	138.00	56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Vangjel	Hasan	Ramolli	1631	80/8	Arë	214.00	80.8	17,280.50		56,000.00	K-34-126-(119-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Jorgo	Neki	Ramolli	1631	80/6	Arë	249.00	63.1	15,718.13		15,718.13	K-34-126-(119-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Pandi		Binjaku	3668	281/46	Arë	89.00	41.3	3,671.25	534.00	56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Leksa		Zguri	3668	281/47	Arë	144.00	63.1	9,090.00	864.00	56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Theodhor	Ramadan	Banushi	1355	31/11	Arë	386.00	97.3	37,538.50		37,538.50	K-34-114-(238-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Rami		Banushi			Arë				6,257.06	6,257.06		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
11	Flamur	Riza	Hatija										
	Xhezmije	Rapi	Hatija										
	Lorenc	Flamur	Hatija										
	Vangjel	Flamur	Papa	3173	42/9	Arë	337	103.5	34,879.50	2,022.00	36,901.50	K-34-112-(167-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
	Resmi	Flamur	Hatija										
	Flutur	Riza	Xhanaj										
	Fetije	Riza	Kulli										
12	Kalem		Plashniku	8503	24/27	Ullishte	348.00	81.1	28,231.50	6,488.00	34,719.50	BR-I-9	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Perparim	Alush	Boduri	3754	28/7	Arë	254.00	103.5	26,289.00		26,289.00	K-34-125-(18-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Refit	Nazif	Hysi	2632	40/5	Arë	203.00	81.1	16,468.38	3,146.50	19,614.88	K-34-125-(18-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Veli	Selman	Alibeja	2881	523/13	Arë	385.00	103.5	39,847.50	6,337.10	46,184.60	K-34-112-(188-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Gazmon		Bajraktari	1355	119/1	Arë				5,490.00	5,490.00	K-34-114-(237-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
17	Jorgo	Stefan	Priftuli	3903	75/3/21	Arë				2,608.32	2,608.32	K-34-114-(236-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
18	Lytije		Mullalli	3903	31/111	Arë				126.00	126.00	K-34-114-(236-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
19	Erion	Teki	Pillati	1403	137/38	Arë				1,419.00	1,419.00	K-34-126-(25-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
20	Durim		Beqiri	1984	227/18	Arë				1,316.80	1,316.80	K-34-112-(166-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
21	Astrit		Laska			Arë							Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Pelivan		Lirjani	3301	32	Arë					174.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Pellumb		Nepajaj			Arë							Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
22	Donika		Xhela	3196	64/5	Arë				8,825.70	8,825.70		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	TOTALI						3,196.00		290,223.38	47,776.98	626,048.86		



TABELA NR. 4
RRETHI: KORÇË
LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari			ZK.	Nr.	Lloji pas.	Sip. m ² Shpronësim	Çmimi/m ²	Vlera, lekë	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
1	Stavri	Thoma	Kondili	3790	367/10	Arë	24.00	505	12,120.00	12,120.00	K-34-126-(99-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Robert	Ilo	Kurtiqi	3790	849/6	Arë	29.00	505	14,645.00	14,645.00	K-34-126-(116-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Spiro	Pandeli	Dhëmbi	3790	225/11	Arë	62.00	330	20,460.00	20,460.00		Konfirmuar nga ZVRPP
	Totali						115.00			47,225.00		

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 308 lekë